



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**RAPORT I PUNËS SË NJËSITEVE KOMUNALE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT**

Janar-Qershor, 2010

Hyrje

Çështja e njohjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut është temë kryesore e cila duhet të tërheq vazhdimisht vëmendjen e Institucioneve të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës posedon një spektër të gjerë të ligjeve në fushën e të drejtave të njeriut, duke filluar nga Kushtetuta e cila që nga neni 21 deri në nenin 56 i kushton vëmendje të veçantë fushës së të drejtave të njeriut, kemi edhe një numër të madh të ligjeve të cilat i dedikohen kësaj fushe siç janë: Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për të Drejtat e Komuniteteve, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Barazi Gjinore etj.

Janar -Qershor 2010

Lidhur me aktivitetet e komunave për realizimin e Planeve të Veprimit që dalin nga objektivat e Strategjive Kombëtare, Divizioni për të Drejtat e Njeriut në MAPL, në vazhden e veprimeve të përbashkëta me organet komunale që ndërliken me avancimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal, ka iniciuar krijimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna e cila u finalizua me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ 2007/08 i cili më vonë ndryshohet konform Rregullores 2007/30 me Udhëzimin administrative nr. 2008/02 për "Themelimin e Njësiveve Komunale për të Drejtat e Njeriut".

Komuna e Fushë Kosovës

Zbatimi i akteve ligjore dhe rregulloreve komunale për të drejtat e fëmijëve, që bëjnë parandalimin e veprimeve që cenojnë dhe mohojnë liritë dhe të drejtat e fëmijëve, siç janë: trafikimi me fëmijët, ushtrimi i dhunës ndaj tyre, parandalimi i punëve të rënda për fëmijët etj.

- Organizimi i fushatës nëpër shkolla kushtuar 22 - prillit ditës së Tokës. Në këtë rast është formuar grupi i ekologeve.
- Është zhvilluar fushatë vetëdijësuese, me rastin e 22- majit "Dita kundër braktisjes së fëmijëve";
- Është shënuar 1 - Qershorit Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Është promovuar rregullorja për mbrojtjen e fëmijeve që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, te nxënësit e shkollave fillore.
- Promovimi i kontakteve nacionale, ndëretnike në bashkpunim me aktivitetet e grave;
- Vizitë pune në komunën e Dragashit me gratë e të gjitha komuniteteve të komunës sonë.

- Tryeza,Debate të përbashkëta me gratë e të gjitha komuniteteve për tu njohur me afër me problemet me të cilat ballafaqohen ato dhe mënyrat e integritit në shoqëri.
- Fuqizimi dhe promovimi i grave për drejtat e tyre përmes projekteve,fushatave të ndryshme
- Implementimi i projektit, "Pjesëmarrja e grave në Jetën Publike Lokale."Projekti do të zgjasë deri në fund të vitit 2010.
- Zhvillimi i debateve , takime, vetëdijësuese me gratë me qëllim të inkurajimit të tyre për të qenë me aktive në jetë.
- Faza a parë - Njohja e problemeve të ndryshme të grave në viset rurale.
- Prezentimi i problemeve para institucioneve përkatëse dhe asamblistëve komunal.
- janë bërë organizimi i tryezave të rumbullakëta për legjislacionin vendor që mbron të Drejtat e Njeriut, trajnime, seminare, debate etj.
- Hulumentimi dhe grumbullimi i të dhënave për identifikimin e nevojave për promovimin dhe përhapjen e vlerave dhe praktikave në fushën e të drejtave të Njeriut.
- Janë organizuar takime , është bërë shënimi e datave që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në partneritet me OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore që mirën me drejtat e Njeriut

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit, me vendimin nr. 200-347 , të mbështetur në nenet 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenet 40 dhe 41 të Statusit të komunës së Lipjanit nr. 110= 623 ka shpallur muajin prill "muaj për regjistrimin falas për të pargjistruarit dhe fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas". Ky aktivitet është ndërmarrë për realizimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptas (objektiva, regjistrimi, aktiviteti 1.1, veprimi 1.2.3, "njëherë në vit komunat të shpallin muajin për regjistrim falas për të pargjistruarit, fëmijët e lindur jashtë sistemit shëndetësor").

- Integrimi i te drejtave të njeriut në çështjet gjinore, përmirësimi i gjendjes aktuale, përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë te DNJ.
- Vetëdijësimi,informimi dhe mësimi i njerzëve për të drejtat e tyre dhe për mënyren më të mirë të shfrytëzimit të drejtave.
- Aksioni regional i shoqërisë Civile për ngritjen e vetëdijes dhe Tolerancës" Në këtë takim kanë marr pjesë përfaqësues të organizatave për të drejta te njeriut,përfaqësues të institucioneve juridike dhe atyre profesionale, përfaqësues të qeverisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile të cilët kanë eksperiencë të mjaftueshme në ballafaqimin me të kaluarën dhe

me procesin e kthimit dhe integritit të minoriteteve si dhe vet përfaqësues nga të gjitha komunitetet.

- U shënua Dita Nderkombëtare e Tokëtes me 22 prill 2010 "PROJEKTI FURNIZIMI ME Fidane.

Grate kryefamiljre dhe familjet e deshmorve "Pjesëmarrja e Grave në Jetën Publike Lokale Ne kuadër te projektit Projekti "Aksioni regional i shoqërisë Civile për ngritjen e vetëdijes dhe Tolerancës" është organizuar trajnimi me temen "Avokim dhe Lobim. Ne ket trajnim kan marre pjesë perfaqesuesit nga te gjitha grupet minoritare. Qëllimi i këtij takimi ka qenë njohja më për se afërmi me te gjitha problemet dhe vështërsit që i kemi ne forma te ndryshme ,vlen te ceket se ka qene me rendesi edh takimi me deputete komunale ku edhe eshte formua grupi jo formal i grave per te perkrahur gruan , ne te gjitha fushat e e jets.

Komuna e Skenderajt

NJDNJK në komunën e Skenderajt është ballafaquar me dukurinë e braktisjes së shkollës nga radha e të rinjve prandaj aktivitetin e vet e ka intensifikuar për ndërprerjen e kësaj dukurie. Prandaj ka bërë identifikimin e rasteve , bisedat dhe anketat me nxënësit të cilët e kanë braktisur shkollën dhe prindërit e tyre me qëllim për tu njoftuar me shkaqet e braktisjes së shkollës.

Për secilin nxënës është formuar dosje për arsyet e braktisjes së shkollës dhe ndër to numërohen këto arsye: gjendja e keqe ekonomike dhe si pasojë braktisja e shkollës për të punuar, rënia e interesimit për shkollën; pengesat e ndryshme familjare; fejesat dhe martesat e hershme; kushtet e këqija të shkollimit; largësia e objekteve shkollore; vështirësitë që lidhen me udhëtimin; mungesa e transportit; rrethana të ndryshme familjare (vdekja e prindërve -prindit dhe kujdesi ndaj motrave dhe vëllezërve më të vegjël) etj.

Komuna e Obiliqit

- Është organizuar procesi jo formal i mësimit të kësaj komune me qëllim të nxitjes së nxënësve të zhdukjes së analfabetizmit.
- Është zhvilluar fushatë vetëdijësimi për nxënësit me qëllim të mbrojtjes së ambientit me ç`rast është organizuar aksioni për pastrimin e qytetit me nxënësit e SHF "Pandeli Sotiri" në Obiliq.

- Është shënuar “1 Tetori –Dita e fëmijëve” ku nxënësit e SHF“Pandeli Sotiri” kanë organizuar një program argëtues për nxënësit dhe qytetarët.
- Me rastin e 8 Marsit – Dita Ndërkombëtare e Grave është mbajtur një ligjëratë për shënimin e kësaj date.
- Në bashkëpunim me KMLDNJ është realizuar projekti me temën “Aksion Regjional i Shoqërisë Civile për Ngritjen e Vetëdijes dhe Tolerancës”

Komuna e Vushtrrisë

Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka themeluar Komitetin për Parandalimin e dhe Eliminimin e Punëve të rënda dhe të rrezikshme për fëmijët. Ky veprim është ndërmarrë me qëllim të zbatimit të Strategjisë dhe Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009-2013.

- Është shënuar 1 Qershori Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;
- Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kuvendit komunal dhe në këshillin komunal për siguri në bashkësi;
- Me kërkesë dhe iniciativë të NJDNJK-së është realizuar ndihma për kolegën;
- NJDNJK ka iniciuar projektin për grante konkrete në renovim shkollash DKA, nga zyra japoneze në vlerë prej 65 mijë dollarësh;
- Marrja e statistikave gjinore në Stacionin Policor, Gjykata, Handakos, Qendra për punësim;
- Është bërë bashkëpunim me OJQ-të që veprojnë në komunë për realizimin e aktiviteteve.
- Bashkëpunim me DDNJ të MAPL-së, lidhur kushtet e punës të NJDNJK-së dhe realizimin e aktiviteteve.
- Është bërë shënim i Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsi.
- Në bashkëpunim me LËF dhe me grupet e grave në fshatin Maxhunaj u shënuar 22 Marsi dita Ndërkombëtare e Ujit;
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat e qytetarëve të komunës, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut;
- Pjesëmarrja në seminarin me temën: “Eksproprijimi dhe qeverisja lokale”, organizuar nga DDNJ-MAPL. Trajnimi iu dedikua të drejtave të njeriut me theks të veçantë të drejtës pronësore;
- Në bashkëpunim me shoqatën “Martirët e Lirisë” është bërë punësimi i 4 grave kryefamiljare në repartin tekstilit.
- Është bërë vizitë pune në Shtëpinë për Komunitete ku jetojnë persona me nevoja të veçanta në Lumëmadh;

- NJDNJK ka organizuar 24 takime e vizita të komuniteteve dhe ka përgatit raport për kthimin e komunitetit RAE në komunën tonë.
- Gjithashtu janë organizuar përgatitjet për zgjedhjet e kryesisë së fshatit Prelluzh, Gracë, Bajskë dhe komunitetit rom, organizimi i kthimit të 13 familjeve serbe në dy fshatrat Dolak dhe Shtitaricë;
- NJDNJK i ka dorëzuar projektin, ICITAP-it (Departamentit Amerikan të Drejtësisë) në vlerë 24 mijë dollarë për rregullimin e dy rrugëve që lidh komunitetin ashkali dhe atë shqiptarë, si ekipi veprues i Policisë në Bashkësi;
- Pjesëmarrja në solemnitetin e komunitetit ashkali për ditën e flamurit ashkali;
- Aktiviteti për shënimin e 1 Qershorit Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Në bashkëpunim me shoqatën Handakos u realizua shëtitja me fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Në këtë shëtitje ishin gjithsejtë 60 persona, prej tyre 30 fëmijë me aftësi të kufizuar .

Komuna e Dragashit

Aktiviteti kryesor i angazhimeve në kuadër të objektivave që dalin nga Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut ka qenë monitorimi i vazhdueshëm i organeve përgjegjëse për zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve të miratuara, sic janë: Asambleja Komunale, Komitet obligative të themeluara nga Kuvendi Komunal, Zyra për kthimin e personave të zhvendosur ,Shërbimet e Drejtorive komunale, etj.

Në muajin janar pas zgjedhjeve lokale është themeluar asambleja Komunale e Komunës së Dragashit e cila përbëhet nga 27 këshilltarë me përfaqësim të disa subjekteve politike prej të cilave 5 subjekte shqiptare dhe 3 boshnjako-gorane. Asambleja është funksionale dhe mban takime të rregullta. Përfaqësimi i komuniteteve dhe zgjedhja e tyre është bërë konform ligjeve në fuqi. Si çështje shqetësuese është identifikuar mos themelimi i komiteteve obligative, megjithëse themelimi i tyre ka qenë dy here pikë e rregullt e rendit të ditës.

Krahas Asamblesë komunale njësitë ka vazhduar monitorimin e punës edhe të drejtorive komunale në marrjen e shërbimeve nga qytetarët. Gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar ankesa në kutinë e ankesave të vendosur në hyrje të Kuvendit Komunal as në Drejtorinë për Administratë e as në Zyrën për Komunitete. Qytetarët i marrin të gjitha shërbimet në gjuhët që ata janë të përcaktuar me Statut të Kuvendit Komunal dhe Rregulloren për përdorim të Gjuhëve. (gjuha shqipe, Serbe dhe Boshnjake të miratuara në Statutin e Komunës (neni 6 . pika 6.2).

Sa i përket barazisë gjinore, mbetet sfida implementimi i tërësishëm i Ligjit për Barazi gjinore. Edhe përkundër asaj se janë bërë përparime në këtë fushë ende mbetet shumë për tu bërë. Zyra për Barazi Gjinore është angazhuar maksimalisht në respektimin e barazisë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin e një shoqërie. Për fat të keq ende nuk është arritur një nivel i mirë i raportimit të mosrespektimit të barazisë gjinore. Kjo krijon edhe vështirësi në evidentimin e rasteve të personave të keqtrajtuar.

Njësia i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Mundësi të Barabarta dhe PAK. Ajo ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq, Hendikosit dhe Qendrës për Punë Sociale. Duke pasur parasysh gjendjen e mëhershme trajtimi i kësaj kategorie është në rritje e sipër. Aktivitetet e QPS, Kryqit të Kuq, Hendikos në mbështetje të kësaj kategorie dhe përgjithësisht mbështetja e familjeve skamnore ka ndikuar në trajtim më të mirë. Gjithashtu janë zhvilluar kontakte me drejtorin e Drejtorisë Komunale për arsim, me ç'rast është konstatuar se 5 nxënës me nevoja të veçanta në shkollën fillore "28 Nëntori" trajtohen mirë dhe se paralelja me këta nxënës ka kushte të përshtatshme për aktivitetet e tyre. Drejtorja e Arsimit ka angazhime edhe në hapjen e paraleleve të tjera për këtë kategori. Shqetësuese mbetet lëvizja e kësaj kategorie ngase objektet e vjetra në përgjithësi nuk e kanë të rregulluar stazën për lëvizjen me karrocë. Disa objekte e kanë të rregulluar por tek pjesa me e madhe ajo mungon. Edhe pse ka përparime në këtë drejtim ende mbetet e pakënaqshme pozita e individëve me aftësi të kufizuara që shpesh mbahen larg nga opinioni publik e që kjo gjithësesi ndikon në mos integrimin e tyre në shoqëri. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt që ata të mos jenë pjesë e tregut të punës dhe gjithësesi të mbeten të izoluar nga rrethi ku jetojnë.

Në këtë fushë është konstatuar se Ligji për të Drejtat e Komuniteteve zbatohet pothuajse tërësisht. Ka raste të pakta të moszbatimit por ato nuk ndikojnë në mos zbatueshmërinë e tij ngase lidhen me procedura teknike të këtyre lëshimeve. Për të avancuar edhe me tutje të drejtat e komuniteteve, Njësia ka monitoruar vazhdimisht ofrimin e shërbimeve nga të gjitha institucionet, e veçanërisht takimet e Asamblesë Komunale, Komitetit për Komunitete, Bordit të Drejtorëve, Zyrës për Kthim, Zyrës së komuniteteve dhe punën e Drejtorive. Në çdo takim Njësia është përfaqësuar me një anëtar të tij.

Një vëmendje e veçantë u është kushtuar edhe takimeve të mbajtura nga zyra për kthimin e personave të zhvendosur. Deri me tani janë mbajtur dy takime ku është implementuar strategjia e veprimit të kësaj zyre. Nga zyra për kthim situata e sigurisë në komunë është vlerësuar si mjaft stabile, nuk ka pasur asnjë eksces ndëretnik dhe janë raportuar raporte të mira ndëretnike, edhe pse një pjesë e shkollave punojnë në sistem paralel në gjuhën serbe, përkatësisht goranë, ka pasur lëvizje të lirë të qytetarëve e respektim të gjuhës së komunitetit pakicë.

Nuk është evidentuar asnjë shkelje serioze e të drejtave të minoriteteve dhe kjo argumentohet me faktin se deri me tani nuk ka pasur ankesa.

Ligji për përdorimin e gjuhëve në komunë zbatohet pothuajse në tërësi. Në takimet e asamblesë komunale, Njësia ka konstatuar se ftesat për takim dhe materiali për shqyrtim dërgohet me kohë dhe i shkruar në të dy gjuhët si dhe diskutimet e delegateve behën në të dy gjuhët dhe përcillen me përkthim simulant. Asambleja Komunale përbëhet nga 27 delegatë. Nga radhët e komunitetit pakicë është i zgjedhur nënkryetari i komunës dhe zëvendës kryesuesi i Asamblesë Komunale.

Shkelje të të drejtave të njeriut nuk është evidentuar edhe me rastin marrjes së dokumentacionit dhe pranimit të palëve nga zyra e pranimit. Gjithashtu nuk është evidentuar shkelje edhe me rastin e organizimit të aktiviteteve kulturore, rinore e sportive. Ftesat për pjesëmarrësit ndahen në të dy gjuhët dhe përfaqësimi në paraqitjen e programeve është i lirë për të gjithë.

Duke pasur parasysh faktin se komuna e Dragashit përbëhet nga dy komunitete dhe mësimi mbahet në dy gjuhë, anëtarët e njësimit në mënyrë permanente i kanë kushtuar rëndësi respektimit të të drejtave të fëmijëve , barazisë gjinore dhe qasjes së barabartë për të gjithë. Deri në periudhën raportuese nuk ka pasur asnjë rast të raportimit zyrtar. Edhe shërbimet shëndetësore merren pa dallim gjinie apo komuniteti dhe në të gjitha rastet respektohet dygjuhësia.

Komuna e Dragashit e ka të miratuar rregulloren komunale për të drejta e fëmijëve. Kjo rregullore siguron mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre si alkooli, duhani, narkotiket, punët e rënda, shfaqjet degjeneruese , etj.

kjo rregullore ende nuk ka gjetur implementim të plotë ngase gjatë monitorimit kemi konstatuar se tek një pjesë e madhe kjo nuk respektohet ngase fëmijët ende mund të shërbehen me alkool, duhan dhe ende bëjnë punë të rënda. Në këtë drejtim mund të veçojmë subjektet tregtare dhe një pjesë e familjareve që në mungesë të fuqisë punëtore shfrytëzojnë fëmijët për punë që nuk i takojnë nivelit të tyre.

Nga statistikat e Qendrës për Punë Sociale janë evidentuar pesë raste të fëmijëve jetim pa përkujdesje prindërore e që janë në përkujdesje të QPS-së. Raste të trafikimit të fëmijëve dhe përgjithësisht trafikim të qenieve njerëzore nuk ka pasur.

Komuna e Malishevës

- Janë organizuar fushata vetëdijësuese gjithëpërfshirëse lidhur me perspektivën e barazisë gjinore në shoqëri, arritjen e barazisë gjinore dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore.
- Mbledhja e statistikave në këndvështrimin e perspektivës gjinore për punëtorët e shërbimit civil të komunës së Malishevës si dhe të papunësuarve të regjistruar në entin e punësimit
- Janë evidentuar rastet e dhunës familjare dhe është bërë adresimi tek organet kompetente për mbrojtjen e viktimave
- Është bërë ofrimi i shërbimeve të ndryshme (rasteve sociale, kryesisht nëna që rrisin fëmijë bonjakë, si kategori më e cenuar) me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut.
- Janë shpërndarë fletëpalosje, billboard, nëpër shkolla për ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrat e tyre.
- Organizimi i takimeve në nivel lokal dhe regjional.
- mbajtja e takimeve të përbashkëta me OJQ-të aktive që funksionojnë në komunë.
- Pjesëmarrja aktive në mbledhjet e bordit, mbledhjen e KPF si dhe mbledhjen e Kuvendit
- pjesëmarrja në panelet intervistuese (anëtare-kryesuese)
- shënimi i një qershorit - ditës ndërkombëtare të fëmijëve, në të gjitha shkollat fillore ku janë u mbajt një ligjërate për të drejtat e fëmijëve dhe u shpërnda fletëpalosja me përmbajtjen e të drejtave të tyre.
- Takime të rregullta me përfaqësuesit e zyrës regjionale të Ombudspersonit.
- Është bërë përgatitja e planit të veprimit për të drejtat e njeriut.
- Janë mbajt takime të rregullta me zyrtarët e OSBE-s.
- Në Komunën e Malishevës janë gjithsej nëntë familje minoritete: dy ashkali, shtat rome.
- Këta janë nën përkujdesjen e komunës, ndër ta janë edhe dy të punësuar, ndërsa gjashtë familje janë në përkujdesje të Qendrës për punë sociale.
- Në gjashtëmujorin të parë të këtij viti janë bërë vizita të kohëpaskohshme në familjet e komunitetit RAE, janë zhvilluar takime me OSBE-në, UNHCR-në ku është diskutuar për varrezat e serbëve në fshatin Kijevë.
- Gjithashtu janë zhvilluar takime me zyrtaren për të drejtat e pakicave nga Ministria e Bujqësisë ku kemi diskutuar për integrimin e pakicave në aktivitete bujqësorë.

Komuna e Mitrovicës

- Është hartuar raport për zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.
- Bashkëpunimi i institucioneve relevante për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimi i NJKDNJ.
- Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë, në kontest të të drejtave të njeriut. Mbikëqyrja dhe monitorimi i sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe të drejtave të punëtorëve.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të mesme. Si objektivi ishte parandalimi dhe zvoglimi i përdorimit të pirjes së duahnit, drogës, pijeve alkoolike, në vende publike posaqërisht fëmijëve dhe të rinjëve.
- Sigurimi i qasjes për të gjithë qytetarët e Komunës në dokumentet zyrtare dhe informata.
- Rritja e transparencës në institucionet komunale.
- Funksionalizimi i Zyrës për Informim.
- Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore. Zbatimi i Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë (2008 - 2011).
- Përmirësimi i situatës së të drejtave të fëmijëve dhe Fuqizimi i mekanizmave institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Përcaktimi i prioriteteve në fushën e të drejtave të fëmijëve.
- Janë bërë hulumtime rreth numrit të fëmijëve që bëjnë punë të rënda dhe janë marr masa për zbatimin e SPV për parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve, në bashkëpunim me Shqoërin Civile dhe grupet tjera të interseit.
- Janë zhvilluar aktivitete lidhur me zbatimin e programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Ulja e rasteve të diskriminimit gjinor.
- Rritja e nivelit të respektimit të të drejtave në kontestin e barazisë gjinore në Komunë.
- Monitorimi i rekrutimit në punësim në kontekst të të drejtave të njeriut
- Organizimi i fushatës promovuese për të drejtat në punë të komunitetit romë dhe ashkali në komunë.
- Janë zhvilluar fushate vetëdijësuese për Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore, në bashkëpunim me ,CBI, Policia e Kosovës, Mbrojtësi i viktimave, NJKDNJ, OJQ-të; Qendra për Mbrojtjen e Grave të fëmijëve, perfitues, profesor dhe nxënës të SHM. "Frang Bardhi.
- Pjesëmarrja dhe qertifikimi lidhur me të drejtata e fëmijëve,
- Pjesëmarrja e rregullt në Bordin e Qendrës për aftësime profesionale,
- Pjesëmarrja në takimet e rregullta me zyrtaret për barazi gjinore,

- Pjesëmarrja në realizimin e projektit “Luftimi i trafikimit të qenieve njerzore, të arriturar dhe sfidat” të organizuar nga CBI,
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Shoqata Mundësia “Të drejta e gruas për punë”,
- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga DDNJ-MAPL.
- Për periudhën janar-qershor është grumbullim e të dhënave statistikore nëpër të gjitha institucionet komunale.

Komuna e Gjilanit

- Me 6 mars Grupi joformal i grave në bashkëpunim me OSBE-në për nder përvjetorit të themelimit të grupit ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me moton: “Jo lule veç një ditë, por barazi për tërë jetën” e cila njëkohësisht ka pasur për qëllim jo vetëm shënimin e kësaj date por edhe ndarjen e mirënjohjeve personave të cilët kanë dhënë kontributin e vet në formimin e këtij grupi.
- Më 18 mars me ftesën e Organizatës Joqeveritare “Dëgjo Rini’ është mbajtur ligjëratë para nxënësve të shkollave të mesme me rast nxënësit janë njoftuar me institucionet dhe mekanizmat të cilët zbatojnë ligjin për Barazi gjinore dhe të Drejtat e Njeriut në komunën e Gjilanit.
- Pjesëmarrja në debatin e organizuar nga “Rrograek” (rrjeti i grave rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë) me qëllim të informimit me gjendjen aktuale të arsimimit të komunitetit rom.
- Sipas kërkesës të grave nga KK-Ulqin, është realizuar një vizitë studimore në Komunën e Gjilanit, prej datës 22 deri më 25 prill 2010, në kuadër të projektit “Gruaja dhe trashëgimia”.
- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Familjes janë anketuar qytetarët e të gjithë komuniteteve të komunës së Gjilanit me qëllim që të identifikohen problemet me të cilat ballafaqohen ata, si dhe me qëllim të njohjes së tyre me Udhëzimin Administrativ në bazë të të cilit disa kategori dhe disa persona lirohen nga pagesa gjatë kontrollimeve mjekësore.
- Më 1 qershor, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Zyra për barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut ka realizuar projektin “Fëmijët dhe të Drejtat”.
- Me 9 qershor pjesëmarrja në trajnimin e realizuar nga MAPL në bashkëpunim me OSBE-në, me temën “Të drejtat e njeriut dhe reintegrimi i personave të riatdhesuar”.
- Pjesëmarrja në realizimin e projektit “Ngritja e vetëdijes dhe përfshirja e autoriteteve lokale në fushën e Trafikimit me qenie njerzore” të organizuar nga OSBE-ja.

Komuna e Vitisë

Aktivitetet e NjDNjK-së:

- Monitorimi i ofrimit të mundësive të barabarta gjatë rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në procesin e intervistimit);
- Ofrimi i rekomandimeve për rregulloren Komunale për ngarkesa, taksa dhe gjoja, për lirim nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë;
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët në sektorin e Ofiqarisë si dhe sektorë tjerë;
- Ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave në marrjen e dokumenteve identifikuese për qytetarët;
- Monitorimi i zbatimit të Rregullores Komunale për mbrojtjen e të Miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre;
- Zhvillimi i një pyetësori për ndikimin e pijeve alkoolike dhe të duhanit në mësim-nxënie;
- Sensibilizimi i qytetarëve për të drejtat e njeriut, përmes fushatave;
- Mbajtja e takimeve dhe tryezave me qytetarë (grupmosha të ndryshme) për të drejtat dhe liritë themelore;
- Shqyrtimi i ankesave për shkelje eventuale të të drejtave të njeriut;
- Organizimi i tryezës “ Jo lule një ditë, por barazi çdo ditë” .
- Formimi i Grupit Joformal të Grave;
- Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve (Financuar nga KMDLNJ);
- Hartimi dhe aprovimi i Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve;
- Organizimi i debateve publike me Drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve;
- Organizimi i një shfaqjeje teatrale për fëmijë;
- Organizimi i debatit “ Luftimi i dukurive negative te rinia;
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të;
- Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Organizimi i një pikniku për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Inicimi dhe hartimi i projektit “Mbrohu nga trafikimi me qenie njerëzore”;
- Hartimi dhe botimi i fletëpalosjeve për nxënës të shkollave të mesme;
- Shpërndarja e fletëpalosjeve “ Siguria e vajzave të reja “.

Komuna e Kaçanikut

- Hartimi i raportit për 6-mujorin e parë të vitit
- Takim me OJQ- në Inter Logos co-operation dhe ofrimi i bashkëpunimit lidhur me barazinë gjinore;
- Shënimi 8 Marsit – tryezë e rrumbullakët me gratë e institucioneve;
- Vizita i çerdhes së fëmijëve "AGIMI " dhe vlerësimi i kushteve, higjienës së çerdhes;
- Vizitë në disa shkolla fillore dhe te mesme, vlerësimi i kushteve dhe ambienteve shkollore;
- Takim me drejtorin e shkollës se mesme "Skënderbeu" dhe inicimi i rastit për mos përjashtimin e tri vajzave për shkak te mbulesës me shami;
- Përcjellja e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve të komunës;
- Pjesëmarrja në procesin e intervistimit të kandidatëve konkurrues në konkurset e komunës;
- Takimet e rregullta me anëtarët e draft marrëveshjes, mes zyrtarit për barazi gjinore dhe institucioneve relevante në komunë;
- Takime të rregullta me sektorin për komunitet të Policisë së Kosovës të stacionit të Kaçanikut lidhur me dhunën në familje dhe delikuencën e të miturve dhe vetëdijesimin e familjes dhe të komunitetit për liritë dhe të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve;
- mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe mundësi të barabarta;
- Ofrimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara për përfitimin e ndihmës sociale nga enti social;
- Ofrimi i ndihmës në zyrën e pritjes lidhur me pajisjen e qytetarëve me dokumentacione të nevojshme personale;
- Formimi i grupit joformal të garave lidhur me ngritjen e kapaciteteve dhe vetëdijesimit te tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe vendimmarrjen;
- Takime me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare (handikos, shpia e shpreses, cdu, kfor soce etj);
- Ndjekja e seminareve dhe trajnimeve;
- Takime të ndryshme me drejtoritë komunale dhe institucionet tjera lokale.
- pjesëmarrja e disa nxënësve në aktivitetin „Të gjithë në borë"-në Brezovicë
- Me ftesëe OJQsë „The door"nga Shkodra ,55 fëmijë kanë marrë pjesë në një festival të lojrave popullore si dhe janë zhvilluar dy lojë miqsore në futboll të madh për meshkuj dhe femra.
- Në kuadër të programit EDYK-nga GTZ gjermane është organizu një vizitë studimore në Koln të Gjermanisë,ku qëllimi ishte forcimi dhe zhvillimi I Ndihmës për të Rinjë dhe Fëmijë në Kosovë.
- NJDNJ i ka bërë vizitë shkollës fillore „Agim Bajrami"në fshatin Stagovë-me rastin e ushtrimit të dhunës së arsimtarit ndaj nxënësit me crast janë

marrë deklaratat e drejtorit të shkollës, nxënësit viktimë si dhe nxënësve dëshmitarë të rastit, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe parandalimit të kësaj dukurie.

- Me rastin e ditës së Evropës-është organizuar një kros në vrapim si dhe një ekspozitë,me qrast kanë marrë pjesë edhe disa nxënës të shkollave fillore.
- Organizimi I shfaqjes për fëmijë „Mbreti gjumash“-nga teatri I të rinjëve dhe fëmijëve në Prishtinë.
- Shënimi I 1Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve-ku është shfaqur një program kulturo-artistik për fëmijë.
- Pjesmarrja e rregullt në takimet që i organizon Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. (koodrinatori është anëtar i KKS).
- Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit sa i përket përkrahjes së viktimave të dhunës në baza gjinore, DDNJ bënë Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të institucioneve kompetente të cilat mbrojnë, përkrahin, marrin vendime dhe strehojnë viktimat e dhunës në familje

Komuna e Kamenicës

- Krijimi i ndërgjegjësimit në drejtim të edukimit për krijimin e një familje të shëndoshë;
- NJDNJK ka bërë anketimit me nxënës lidhur me të Drejtat dhe detyrat e Fëmijëve (nxënësve) në edukim dhe arsim;
- Mbatja e trajnimit me nxënës e shkollave fillore me qëllim të ngritjes së njohurive të tyre për të drejtat e fëmijëve;
- Në muajin maj të këtij viti është zhvilluar një anketë në disa shkolla fillore te Komunës së Kamenicës. Qëllimi i kësaj ankete ishte masa e përdorimit të dhunës në shkolla, në çfarë mase është e shprehur ajo(Si rezultat ka dal se nuk ushtrohet dhunë e dukshme nëpër shkolla);
- si dhe njohja e fëmijëve me Konventen Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.
- Shënimi i 1 qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve .
- Është bërë Promovimi i Njesisë Komunal për të Drejtat e Njeriut.
- Shpërndarja e fletëpalosjeve është bërë për vetëdijesimit e të gjitha komuniteteve lidhur me të Drejtat e Njeriut në Komunën e Kamenicës.

Komuna Klinës

Gjatë muajve janar dhe shkurt është mbajtur takimi për formimin e grupit themelor punues të partneritetit, me specifika të ndryshme për zhvillimin ekonomik të Komunës së Klinës të mbështetur nga BE-ja për Zhvillimin Ekonomik Regjional të Kosovës.

Organizimi i trajnimit dy ditor me temën: "Të Drejtat e Gruas dhe Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Programet e Trajnimeve për të Drejtat e Njeriut në përgjithësi" përkrahur nga Komuna.

Pjesëmarrja në debatin me temën: "Një ambient i përshtatshëm - Shoqëri për të gjithë", të organizuar nga Handikosi.

Është mbajtur trajnimi dy ditor me temën: "Qeverisja me pjesëmarrje", të organizuar nga ATRC në bashkëpunim me NJDNJK-në.

Organizimi i trajnimit dy ditor me temat: "Pasqyrimi i nevojave të komunitetit", në bashkëpunim me OJQ-në "Qeliza", nga Gjakova.

Pjesëmarrja në seminari me temën: "Të drejtat e minoriteteve", të organizuar nga KMDLNJ.

Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Ministria e Pushtetit Lokal në përkrahje dhe bashkëpunim të misionit të OSBE-së me temën: "Aplikimi i Legjislacionit për të Drejtat e Njeriut, të Drejten mbi Pronën".

Pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga OJQ "Koha", në bashkëpunim me komunën me temën: "Lidhja Prind-shkollë nxënës".

Inicim për formimin e komiteteve nëpër shkolla për të drejtat e fëmijëve

Komuna e Istogut

NJDNJK, frekuentohet nga qytetarë e të gjitha kategorive ekonomike, nacionaliteteve të ndryshme për të kërkuar ndihmë në realizimin e të drejtave të tyre:

- * për të drejtën e pronës, 1 palë
- * drejtën jetesës së dinjitetshme, 5 "
- * drejtën mbrojtjes nga dhuna, 3 "
- * drejtën e bashkimit familjar 1 "
- * drejtën e strehimit, 6 "
- * drejtën sociale dhe shëndetësore 6 "

NjDNJK, ka mbajtur disa trajnime në fushën e barazisë gjinore , të të drejtës së komuniteteve , dhe të drejtës së fëmijëve.

Janë zhvilluar aktivitete me karakter përkujtues (festa) me moton promovimi i të drejtave të njeriut dhe fushata kundër diskriminimit.

Pjesëmarrje në punën e mekanizmave të ndryshëm komunal për të promovuar barazinë gjinore , mundësitë e barabarta .(Komisione dhe Komitete).

NjDNJK ka bërë vëzhgimin e situatës: kthimin e komunitetit serb dhe të komunitetit RAE.

Janë organizuar gara shkollore me karakter kombëtar në sporte: futboll , hendboll dhe atletikë , (këto gara janë organizuar në bashkëpunim me OJQ, DAK, dhe NJKDNJ).

Angazhimi i NjDNJK-së, në sensibilizimin e qytetarëve për rëndësinë dhe daljen në zgjedhjet komunale.

Puna e vazhdueshme në komisionin evropian për hartimin e strategjisë zhvillimore për regjion .

Komuna e Pejës

NjDNJ e komunës së Pejës, gjatë këtij gjashtë mujori ka pasur këto aktivitete:

- Ndjekja e trajnimit dy ditorë i organizuar nga MDA me temën “ Komunikimi dhe qasja ndaj qytetarëve .“
- Manifestimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas “8 Mars’ me rast është bërë ndarja e çmimeve laureatë për gratë më të suksesshme në gjashtë fusha;
- Trajnimi I mbajtur me Këshilltarët Komunal I organizuar nga OJQ -ja Qeliza Gjakovë me temën “ Avokimi”,
- Stimulimi I Punëtorëve Për festën e Punëtorëve shënimi i ditës së punëtorëve 1 Maji;
- Ndjekja e trajnimit në Regjionin e Pejës i organizuar nga MAPL dhe OSBE -së me temën “ Aplikimi I Legjislacionit për të d. nj. të drejtat mbi pronën eksproprijimi dhe qeverisja lokale .Bartja e eksperiencave në praktikë
- Pjesëmarrja në Konferencën e ALDA -së i mbajtur në Shkupë .
- Ngritja e Vetëdijesimit dhe Kapaciteteve për njohurit dhe të drejtat e fëmijëve përmes fushatave, trajnimeve, debateve e tj.

- Sensibilizimi i të rinjve dhe informimi i saktë për gjendjen e dukurive negative si: droga, trafikimi, marrja me punë të këqija dhe shërbimet që i ofrojnë Institucionet dhe shoqëria civile,
- Tryeza e rrumbullakët me temën: 'shkelja e të drejtave të grave me miratimin e ligjit të punës i cili parasheh pushimin e lehonisë me 3 plus tre e që është shumë diskriminues për mbarë shoqërinë:
- Sensibilizimi i opinionit për shkeljen e të drejtave të nënës dhe fëmijës lidhur me këtë nënë.
- Ndarja e 8 grandeve për OJQ -të lokale nga OJQ -Syri I vizionit I financiar nga zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Komuna e Prizrenit

Gjatë realizimit të aktiviteteve të parapara me planin veprues për periudhën Janar-Qershor 2010 janë ndërmarrë aktivitetet si vijon:

- Pjesëmarrje të rregullt në mbledhjet e Kryetarit të komunës me Drejtorët e Drejtorive komunale dhe ngritja e çështjeve të ndryshme me qëllim të promovimit dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
- Pjesëmarrja në mbledhjet e rregullta mujore ,me përfaqësuesit e shoqërisë civile, për transparence më të madhe në qasjen e përbashkët të çështjeve të ndryshme si dhe thellimin e bashkëpunimit mes OJQ-ve dhe komunës .
- Pjesëmarrje të rregullta dhe aktive në trajnime dhe seminare të organizuara nga institucionet dhe OJQ-t e ndryshme në fushën e promovimit dhe respektimit të Drejtave të Njeriut(OSBE, Agjencioni ër Barazi Gjinore ,Save the children e tj.)
- Nga kërkesat e parashtruara në adresën e NJDNI, gjatë periudhës Janar-Mars , është bërë shqyrtimi i tyre dhe janë ndërmarrë veprimet e nevojshme:
- është miratuar kërkesa e “Qendrës së strehimit të Grave dhe Fëmijëve” për mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të qirasë, rrymës dhe ujit edhe për vitin 2010. Në këtë mënyrë është dhënë përkrahje e plotë duke marrë parasysh se kjo strehimore ka rëndësi të veçantë për viktimat e dhunës në familje.
- është mbështetur materialisht funksionimi i shoqatës së basketbollistëve në karroca “Marsi” si dhe realizimi i turnirit të klubeve të ngjashme në qytete të tjera në Kosovë, të përfaqësuar nga persona me aftësi të kufizuara.
- në bazë të kërkesës të Shoqatës së verbërve ,duke e pasur parasysh gjendjen e vështirë financiare, e kemi mbështet materialisht projektin e

tyre “ Mësojmë kuzhinën” me qëllim të trajnimit dhe aftësimit të tyre për jetë të pavarur.

- Me datën 8.03.2009, për nder të Ditës ndërkombëtare të gruas 8 Marsin, NJDNJK në përkrahje të komunës ka organizuar një drekë solide për nëpunëset e Kuvendit komunal , gratë e Asamblesë komunale si dhe femrat –police të rajonit të Prizrenit.
- Kemi iniciuar dhe është në proces të planifikimit të realizimit të zbërthimit të Planit kombëtar të veprimit për persona me aftësi të kufizuara në Plan lokal i cili do t’ju përshtatet specifikave të nevojave të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Prizrenit.
- Është iniciuar përfshirja në kontrollime sistematike mjekësore të nxënësve në dy shkollat speciale në Prizren pas pushimit pranveror.
- Është mbështet organizimin e aktiviteteve për nder të Ditës Botërore të Romëve në komunën e Prizrenit.
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga ABGJ me Zyrtaret për Barazi Gjinore në komuna, në temën: plotësimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore
- Gjatë periudhës prill- qershor kemi organizuar tre module të ligjëratave dhe punëtorive me këshilltarët e rinj , në veçanti të dedikuar grave, të Kuvendit komunal të Prizrenit. Realizimin e këtyre aktiviteteve e ka bërë Rrjeti i OJQ-ve të grave “Qeliza” nga Gjakova me temat: Ligji për qeverisje lokale, avokimi, lobimi, komunikimi, paraqitje mediale, etj.
- pjesëmarrja në takimin konsultativ për Draft Planin Strategjik për Gjithë përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe dhënia e propozimeve konkrete.
- Në bashkëpunim me koordinatoren e Programit të GTZ-së në Prizren dhe me OSBE- në , për mbështetje në realizimin e aktiviteteve të “Ditës së vajzave” komuna ka siguruar transportin e vajzave deri tek institucionet dhe ndërmarrjet e ndryshme ku i kanë kryer aktivitetet e tyre. Zyra për Çështje Gjinore, me 3.06.2010, ka organizuar tryezë të rrumbullakët me vajzat pjesëmarrëse dhe aktorët e tjerë të involvuar në shënimin e kësaj dite për të shprehur përshtypjet dhe kërkesat e tyre , të cilat pastaj janë komunikuar tek autoritetet relevante për këtë çështje.
- pjesëmarrje aktive në debatin të organizuar nga “Hendikosi” mbi të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.
- me datën 1Qershor, për nder të ditës së fëmijëve , është realizuar Projekti i Zyrës për Çështje Gjinore “ Dita ime”Ky projekt është mbështetur kryesisht nga komuna.
- Për Zyrtarët e Njesisë për të Drejtat e Njeriut janë mbajtur disa lloje të trajnimeve një ditore siç janë :
- me datën 29.04.2010 ,për Njësinë e të Drejtave të Njeriut MAPL – ja ka organizuar trajnim një ditor në temën e Pronës dhe Shpronësimit.

- Pjesëmarrje në prezantimin e kornizës ligjore që rregullon qasjen në Dokumentet zyrtare organizuar nga OSBE.
- Pjesëmarrje në takimin konsultativ për promovimin e rregulloreve për zhvillim pozitiv social dhe emocional në sistemin arsimor organizuar nga OJQ PMSH nën mbështetjen e USAID-it.
- Pjesëmarrje aktive në Konferencën të mbajtur nga OJQ “VKBIK” në temën “Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë lokale dhe sektorit civil”
- Pjesëmarrja në Punëtorin njëditore në temën e evokimit dhe lotimit, që ka të bëjë me implementimin e Projektit “Aksioni i shoqërisë civile për reformat demokratike dhe promovimi i të drejtave të pakicave në Kosovë” , të cilën e ka realizuar KMDLNJ.
- Edhe në periudhën Prill-Qershor ka pasur mjaft kërkesa të adresuara për NjDNJ të cilat janë shqyrtuar me vëmendje dhe secila sipas prioritetit të nevojave të paraqitura kanë pranuar mbështetjen e duhur :
- është aprovuar kërkesa e shtëpisë së medievet TV Opinion “ për mbështetje financiare për realizimin e projektit “E bukura e Fuqishmja” që përmban në vete emisione javore me femra të suksesshme dhe të shquara në shoqërinë tonë.
- është mbështetur materialisht OJQ-ja e grave “Perspektiva” për pjesëmarrje në Olimpiadën e fëmijëve të organizuar me 1 Qershor, nga MASHT-i, si përfaqësuese e kopshteve të fëmijëve të komunës së Prizrenit.
- Shoqatës së Shurdhërve e cila për zhvillimin e aktiviteteve të veta shfrytëzon një lokal komunal, borxhi i pa paguar për qira i është shlyer dhe figuron si donacion i komunës .
- OJQ e basketbollistëve me karroca “Marsi” u ndihmua me mbulimin e shpenzimeve për rehabilitimin e 4 personave që kanë marrë pjesë në stërvitjet të organizuara në Durrës me rastin e përgatitjes së tyre për garat ndër-komunale.
- OJQ “Iniciativa 6” e komunitetit RAE, është mbështetur për realizimin e projektit të tyre për edukim dhe raporte familjare.
- OJQ -së “Për mendje të shëndosh “ i është siguruar transporti nga ana e komunës për realizimin e projektit “Urat e Integritit të të Rinjve “ me qëllim të zhvillimit të dialogut në mes 5 grupeve të të rinjve të etnive të ndryshme , për pajtim dhe tolerance ndëretnike.
- Në procedurë është sigurimi i OJQ “Hendikos” me një objekt të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të personave me aftësi të kufizuara dhe gjithashtu në shqyrtim të sipër është edhe sigurimi i Strehimores së grave me një ngastër komunale ku donatorë të brendshëm apo të huaj do të investojnë për ndërtimin e një objekti të përshtatshëm për aktivitetet e kësaj OJQ.

- Në vazhdimësi këshillohen dhe ju jepen informata qytetarëve , në veçanti pjesëmarrësit e minoriteteve për ofrim të shërbimeve falas për nxjerrjen e dokumentacioneve të ndryshme(certifikata etj.) si dhe shërbime të tjera.

Komuna e Gjakovës

NDNJ, ka zhvilluar këto aktivitete:

- Në këtë kuadër, kjo zyrë merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore, këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë.
- Me rastin e shënimit të 8 Marsit janë zhvilluar këto aktivitete:
- Shfaqja e filmit dokumentar për të drejtat e gruas mbi trashëgiminë: “Lyp hise, gjej sherr”; stimulohen punëtorët e K.K, Asamblistët ,QPS, Çabratit ,Ngrohtores së qytetit,Bibliotekës ,Teatrit,pastrueset me nga një dhuratë modeste me vlerë prej 10€.
- Takime të rregullta me Organizatat joqeveritare në Komunën e Gjakovës.
- Mysafire ne Radio Gjakovë me temën: “Ngritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i saj” ...;
- ZBGJ ka marrë pjesë nëpër panelet e intervistuesë të shërbyesve civilë (jo në të gjitha), sipas konkurseve të shpallura për punësim, duke u përkujdesur që gjatë procedurave të mos cenohet, por të respektohet barazia gjinore,trajtim te barabarte në kontekst të zbatimit te drejtave te njeriut
- Organizim i mbledhjeve informativ-konsultative me OJQ-të lokale të grave K. Gjakovës.
- Dhënia e informatave dhe njoftimeve të ndryshme në DNJDNJ - MAPL dhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, si dhe plotësimin e pyetësorëve;
- Marrja pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën: Bazat ligjore kundër korrupsionit-Projekt ligji për financimin e subjekteve politike e organizuar nga KDI në mbështetje të USAID;
- Marrja pjesë në punëtorinë, si anëtare e Grupit Punues të PLVM, në përpilimin e Rregullore për ambient ku do të parashtrohet në Asamblen komunale për aprovim,e organizuar nga shoqata e IFK-së.

- Përkrahja e shoqatave me PAK në Drejtorinë e Shëndetësisë, për mbështetje financiare të shpenzimeve operative (komunale);
- -Bashkëpunimi me OSCE, UHCR, Ceri-në, KFOR-in , etj. lidhur me rastet e dhunës në familje, për pozitën e femrës në familje, në shkollë, shoqëri dhe në përgjithësi;
- Arritja e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në mes ZBGJ dhe subjekteve që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave të dhunës në familje;
- Marrja pjesë në debatin mbi prezantimin e Draft -Plani strategjik për organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin Para Universitar në Kosovë.
- Vizitë nga përfaqësuesit e Zyrës Qendrore e OSBE-së në Prishtinë. Qëllimit i vizitës ishte rreth bashkëpunim me Zyrën qendrore të OSBE-së.
- Përcjellja e të dhënave në Ministrinë e Shëndetësisë nga mbi gjendjen e anëtarëve të minoriteteve RAE ,të cilët janë rikthyer në Komunën e Gjakovës prej vendeve të Europës Perëndimore ,si vullnetarisht ashtu edhe jo vullnetare.
- Gjate kësaj periudhe është organizuar trajnim tri ditor me këshilltarët komunal . Seminari është organizuar me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes te kapaciteteve të përfaqësuesve në vendimmarrje si dhe është shpjeguar Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Ky seminar është organizuar nga Rrjeti i Grave Qeliza mbështetur nga Fondacioni Gjerman "Ferdik Efbert Shtiftung" në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore.
- Bashkëpunimi i rregullt i NJDNJ-së me Institucionin e Obudspersonit. Përcjellja e përgjigjes,duke iu referuar shkresës së Ombudspersonit lidhur me ankesat e qytetarëve,për tatimin në pronë e paluajtshmërisë, a ka pasur shkelje të ndaj obliguesve tatimor gjatë vlerësimit në zonat kadastrave në kontekst te zbatimit ne mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Takim i rregullt me Agjencionin për Barazi Gjinore-Prishtinë
- Vazhdimësi e trajnimit me ABGj me qëllim të rishikimit të PKBGJ
- Keshillim ,avokim në Shtëpinë e Sigurt, Qendrën për Punë Sociale rreth rasti të një pale, ,rreth çështjes së strehimit.
- Marrja pjesë në debatin " Policia në shërbim të qytetarëve" e organizuar nga shoqata CBDC nga Gjakova.
- Takim me KFOR-in rreth kërkesës së Shoqatës të Verbërve në mbështetje të projektit për shkrim dhe lexim (brajt) për nxënësit të shkollave ,ku është miratua projekti.
- Marrja pjesë në tryezën e rrumbullaket me temën "Pushimi i lehonisë dhe lobim për zgjatjen e tij.zyrtarja ka konstatuar se është bënë shkelje e te dejtave të njeriut në Ligjin e Punës neni 48.

- Koordinimi i punëve dhe bashkëpunimi i mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut..
- Bashkëpunimi i rregullt i NJDNJ me Institucionin e Ombudspersonit.
- Integrimi i barazisë gjinore në komunën e Gjakovës, që do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike e politike dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialin e tyre individual në dobi të shoqërisë((Zbatimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, Implementimi i LBGJ, në K.K të Gjakovës, Pjesëmarrja e femrave ne Administratën e Komunës së Gjakovës është 77 femra , në pozita vendimmarrëse i kemi dy drejtoresha dhe një femër kryesuesen te kuvendit). Jemi afër zbatimit të ligjit për barazi gjinore ku potencohet se pjesëmarrja e femrave duhet të jetë 40%. Numri i punësuarve ne Kuvendin Komunal të Gjakovës është gjithsej 2228 ku prej tyre 1147 femra dhe 1081 meshkuj.
- Mbledhja e të dhënave të rasteve të dhunës në familje në Shërbimin Policor të Gjakovës dhe në Shtëpinë e Sigurt. Për periudhën janar-qershor 2010 kemi 19 raste nga Policia e Gjakovës ndërsa nga shtëpia e Sigurte 13 raste te dhunës në familje.
- Gjatë kësaj kohe Zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve ka zhvilluar kontakte me koordinatore të drejtat e fëmijëve, punëtorë të shkollave fillore të Komunës së Gjakovës, rreth promovimit të NJDNJ.
- Në bashkëpunim me OSBE-në u mbajt një punëtori ku u diskutua rreth problemit të braktisjes së shkollave si dhe fenomenit të lypjes tek fëmijët.
- Me rastin e 1 Qershorit ditës nder-kombëtare të drejtave të fëmijëve u mbajt një manifestim kulturor-artistik i titulluar “Fëmijët në skenë” ku fëmijët shfaqen program të ndryshme kulturore.
- Pjesëmarrja në punëtorinë një ditore për NJDNJK-të mbajtur në Vermic me temë: shpronësimi organizuar nga DDNJ-MSPL.
- Në bashkëpunim me organizatën e CBDC u mbajt takim pune me temë: Policia dhe kodi i mirësjelljes me qytetar – fëmijë.
- NJDNJ ka ndihmuar komunitetet për tu kthyer nga diaspora dhe regjioni, ka ndihmuar 5 familje dhe nga regjioni i ka ndihmuar 9 familje me gjëra ushqimore dhe jo ushqimore si dhe me regjenerim të të ardhurave. Rreth dokumentacioneve ka ndihmuar me 36 certifikata të lindjes, 0 certifikata të vdekjes, 18 certifikata të kurorëzimit, 18 regjistrime të mëvonshme .

Komuna e Drenasit

Në bazë të plan-programit me arsyetim të projekteve NDNJ posedon buxhet për barazi gjinore me shumë prej 4700€, në emër të subvencioneve për realizimin e projekteve.

Gjatë muajt mars Njësi për Drejta të Njeriut ka realizuar projektin për festën e „8 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Gruas.

Në muajin maj NKDNJ,ZB,DF dhe MB ka realizuar projektim „Edukimi dhe Vetëdijesimi i rinisë mbi dhunën në familje”, ky projekt është realizuar përmes Shoqatës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve”, ku janë mbajtur ligjërata në dy shkollat fillore të larta me klasat e teta dhe të nënta në Shkollën e „Shaban Polluzha” në Korroticë të Eperme, në shollën „Xhevë LLadrovcit” në Gllanasellë, në shkollën Rasim Kiqina në Drenas, në shkollën Ali Gashi në Qikatovë të Re.

NJDNJ, në bashkëpunim me OSBE-në ka realizuar dymbëdhjetë debate në katër fshatra: në fshatin SHtuticë, Godancë, Qikatovë e Re dhe në fshatin LLapushnik, ku në çdo fshat janë mbajtur nga tri debat me temat: Çka prisni ju prej përfaqësuesve komunal ? Çka kërkoni ju për gratë në Komunën tuaj, me çfarë sfida ballafaqoheni ju si gra në Komunën tuaj etj.

NJDNJ gjegjësisht zyrtarja për barazi gjinore anëtare e këtyre komisioneve: komisionit për ndarje të bursave, komisionit për kontrollimin e kërkesave dhe intervenimin e Kandidatëve për Avancim për Shërbyesit civil. Mbi të dhënat për të punësuarit në Shërbimin Civil të Komunës së Drenasit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 janë gjithsejtë 1296 veta të punësuar, prej tyre 512 janë femra dhe 784 janë meshkuj, me fakultet janë 459 veta, me shkollë të lartë 395 veta, me shkollë të mesme 243 veta, 199 veta.

Me ndihmën e donatorëve Komuna ka ndarë dyzetetë bursa për student të cilët e kanë notën mesatare të lartë, si dhe me gjendje të rënd ekonomike si dhe pa prind, shumica prej tyre femra.

Zyrtarja për çështje gjinore kontakte të rregullta për bashkëpunim të rasteve i ka me Komitetin e Shërbimit Civil të SHPK-së, Qendrës për punë sociale dhe OJQ-të.

Në muajt në vijim Zyrtarja do të vazhdon t'i realizoj programet dhe synimet e veta duke mbajtur kontakte të përhershme dhe duke kërkuar ndihmë si nga Zyra e shefit të administratës po ashtu edhe nga Agjencioni për Barazi Gjinore në Prishtinë.

Komuna e Novobërdës

- NjDNj ka organizuar takime me gratë anëtare te shoqërisë civile nga zonat rurale me qëllim të informimit për të drejtat e tyre;
- Shqyrtimi i statistikave për të punësuarit në aspektin gjinor, ku në institucionet e nivelit komunal, 25% e të punësuarve janë femra, kryesisht në sektorin e arsimit e të shëndetësisë. Në pozitë vendim marrëse, në këtë komunë nuk ka asnjë femër, që do të thotë se nuk zbatohet Ligji për Barazi Gjinore;
- Takime, tryeza të rrumbullakëta, trajnime te ndryshme e në veçanti, trajnime për mënyrat e avancimit të femrës në shoqëri, ku vlen te përmendet trajnimi lidhur me ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjin për Trashëgiminë.
- Formimi i Grupit joformal të grave.
- Takime të rregullta me OJQ-të lokale me qëllim bashkëpunimi.
- Takime te rregullta me zyrtarët e regjionit të Gjilanit me qëllim të shkëmbimit të përvojave.
- Ofrimi i transparencës për të gjitha aktivitetet e komunës, për qytetarët e komunës, përmes web-faqes së kuvendit komunal.
- Mbështetja përmes këshillimeve për përfitimin e ndihmave sociale për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve.
- Mbështetja për sigurimin e transportit për nxënësit që udhëtojnë.
- Mbështetja për ndarjen e bursave komunale për nxënës dhe studentë.
- Ligji për përdorimin e gjuhëve zbatohet në vazhdimësi dhe të gjitha dokumentet zyrtare përkthehen në gjuhët zyrtare të palëve.
- Komuna ofron mundësi të barabarta në punësim dhe ka krijuar kushte të përshtatshme për punë për të gjithë.

Komuna e Prishtinës

Takim me gratë anëtare të shoqërisë civile nga zonat rurale me qëllim të informimit për të drejtat e tyre. Statistikat e të punësuarve në baza gjinore . Duke u nisur nga të gjitha institucionet e komunës, përqindja e të punësuarave femra del 25%, ndërsa përqindje te femrës në proceset vendimmarrëse nuk kemi fare, çka do të thotë se përqindjen qe e kemi numri me i madh i tyre vjen nga sektori i arsimit dhe shëndetësisë.

Takime, tryeza të rrumbullakëta, trajnime te ndryshme e në veçanti, trajnime për mënyrat e avancimit të femrës në shoqëri ku vlen te përmendet trajnimi lidhur me ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjin për Trashëgimi. Formimi i Grupit jo formal te grave.

- Takime te rregullta me OJQ lokale me qellim te krijimit të një bashkëpunimi më të ngushtë me komunën.
- Takime te rregullta me zyrtarët e regjionit të Gjilanit me qellim të shkëmbimit të përvojave.
- Zyrtarizimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes ZBGJ dhe të akterëve përgjegjës të viktimave të dhunës në familje, krijimi i rrjetit të bashkëpunimit.
- Ofrimi i transparencës për të gjitha aktivitetet e komunës, për të gjithë qytetarët. Vazhdimisht qytetarët informohen për mes web faqës së kuvendit komunal.
- Shërbime shëndetësore të nivelit primarë pa asnjë dallim si p.sh. vaksinimi i fëmijëve dhe personave të moshuar.
- Ofrimi i ndihmave sociale për një numër të konsiderueshëm të qytetarëve.
- Sigurimi i transportit për nxënësit që udhëtojnë me kilometra te gjata.
- Komuna ka nda bursa për nxënës dhe student.
- Ligji për përdorimin e gjuhëve zbatohet në vazhdimësi, të gjitha dokumentet përkthehen në gjuhët zyrtare.
- Komuna ofron mundësi të barabarta në punësim dhe ka krijuar kushte te përshtatshme për punë për të gjithë.
- Sa i përket personave te zhvendosur komuna ka bërë regjistrimin e personave te kthyer, takime te drejtpërdrejta me ta, si dhe ka shpërndarë ndihma të ndryshme humanitare, vazhdimisht i informojmë qytetarët e komuniteteve pakicë lidhur me të drejtat e tyre.
- Me qellim të ofrimit të mundësive të barabarta në punësim, komuna ka punësuar në administratën komunale disa pjesëtar të komunitetit serb dhe romë.
- Pjesëmarrja në trajnimin me temën: "Të drejtat e njeriut në bazë të bashkëjetesës paqësore", ku për qëllim kishte përmirësimin e gjendjes aktuale, përhapjen e praktikave që promovojnë të drejtat e njeriut si dhe vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut;
- Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët me temën "Aksioni regjional i shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes dhe tolerancës".
- Realizimi i projektit me temën: "Barazia Gjinore dhe Mjedisi i Qëndrueshëm", lidhur me nxitjen e grave për të zhvilluar biznes në pronat e tyre bujqësore;
- Realizimi i projektit me temën: Pjesëmarrja e grave në Jetën publike Lokale', organizuar nga NDNJK dhe financuar nga OSBE. Projekti është zhvilluar në 3 faza. Në fazën e parë janë vlerësuar nevojat e 4 bashkësive lokale. Në fazën e dytë është shqyrtuar mundësia e formimit të grupeve të grave si një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në mes grave dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Faza e

tretë është fokusuar në zhvillimin e një plani veprues mbi barazinë gjinore.

Komuna e Shtimes

Njësiti për të drejtat e njeriut ka vazhduar punën e tij konform ligjit dhe rregulloreve të punës. Njësiti ka kryer disa aktivitete gjatë këtij gjashtëmujori 2010, të cilat ka qenë të fokusuara kryesisht në barazinë gjinore. Aktivitetet janë duke u ndërmarrë në bashkëpunim me zyrën e OSBE-së në Komunën e Shtimes. Janë organizuar disa takime me gratë në fshatrat e komunës si në: Rashinxë, Vojnovc, Muzeqinë, Pjetershticë dhe Petrovë, me temën „Pjesëmarrja e grave në jetën Publike Lokale”.

Në bashkëpunim me OSBE-në është mbajtur një trajnim dy ditor me temën „Prezantimi Publik, Aftësitë Negociuese dhe Udhëheqëse”. NjDNj ka organizuar takim pune për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizuar nga OSBE, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete.

Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga MAPL.

Komun e Deqanit

- Mbledhja e të dhënave statistikore në Entin për Punësim, në bazë të kualifikimit, ngritjes profesionale dhe të gjinisë. Gjithashtu në QPS janë mbledhur të dhënat statistikore të personave që janë shfrytëzues të ndihmës sociale dhe atë në baza gjinore. Gjithashtu janë marrë shënimet për PAK, nga OJQ, Handikos – të ndara në baza gjinore dhe në bazë të kritereve tjera.
- NjDNj ka zhvilluar aktivitete në terren, në kërkim të regjistrimit të nxënësve të komunitetit RAE.
- Gjatë implementimit të projektit të OJQ-së se Gruas „Jeta” në Deçan, ku është mbajtur një Kurs 6 mujor i mësimin të gjuhës shqipe (gramatika e gjuhës shqipe) për komunitetin boshnjak. NjDNj ka qenë pjesëmarrëse e këtij trajnimi dhe ka ligjërue lidhur me drejtat e njeriut, rolin e NjDNj-së dhe për qasjen që mund të kenë në raste të caktuara, kur hasin në padrejtësi dhe në vështirësi tek institucionet e komunës, dhe tek ato mbarë shtetërore. Ky projekt ishte financuar nga OSBE dhe nga USAID.
- Përcjellja e rasteve të dhunës, ankesa, konsultime dhe sugjerime në zyrë?
- Problem. çështja e strehimorëve. Kohë e limituar kushte të papërshtatshme, dhe me në fund kemi edhe thyerje të rendit të shtëpiak si shkelje të ligjit dhe nga banorët,

- Problem kryesor është sigurimi i vendeve të punës për personat që kanë përjetua dhunë në familje dhe pa siguria pas kthimit në shtëpi.
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas (8 Marsi), pjesëmarrja 450 gra.
- NJDNJ ka mbështetur dhe përkrahur mbajtjen e kursit të Rrobaqepësisë „më gratë dhe vajzat të cilën e ka organizuar OJQ- “Jeta”. Në çdo të dytën javë NJDNJ së bashku me një Juriste nga Gjykata është mbajtur ligjëratë lidhur Ligjin për Familjen, të drejta Trashëgimore, Ligjin për barazi Gjinore,dhe të drejtat e njeriut.
- Mbështetje dhe bashkëngjitje në projektin „Jo ndotjes ,për një ambient më të pastër” kryesisht me të rinjtë e shkollave të mesme,ku në grupe defilua nëpër qytet ne shenjë promovimi të pastërtisë së qytetit ku me qese najloni dhe me veshje simbolike (bluza te shënuara „jo ndotjes “) pastrua qyteti.
- Tryezë debati me temën:Femrat asambleistë privilegje apo përgjegjësi?
- Pjesëmarrje në debatin për të Drejtat e PAK,Për një qasje të përshtatshme në objektet publike.”Me shoqatën Handikos dhe se bashku me PAK,pati defilime në qytet, ku u vunë Postierët në ndërtesat e verifikuara që mungojnë qasjet e tilla.
- Punëtori dy ditore me temën:”Zhvillimi I aftësive dialoguese”Po me rrjetin e Gruas „Qeliza” ne Muajin Maj,kemi mbajtur seminarin një ditorë në kuadër te projektit “ pasqyrimi I Nevojave të Komunitetit” I financuar nga Org.Friedrich Ebert Stiftung
- Është shënuar 1 Qershor Dita ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve,ku përveç aktiviteteve tjera fëmijëve ju shpërnda nga njëkopje e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.
- Trajnim dy ditorë për të Drejtat e Gruas,OJQ”Zana”Klinë,në kuadër të projektit,„Ndërtimi I Kapaciteteve dhe Programi I Trajnimeve për Gratë dhe të Dr. e Njeriut” Pjesëmarrëset janë Certifikuar,për pjesëmarrje (30 veta) Qëllimi ishte Fuqizimi I grave me informacione përkatëse në lidhje me Mekanizmat institucional dhe mjetet e tjera përkatëse për zbatimin e rregulloreve dhe Ligjit kundër Dhunës në Familje. Ishin te ftuara punëtore nga KK,Gra aktive dhe gjithashtu gra nga zonat rurale. Projekti i financuar përmes grandit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.
- Tryezë Debati,për Pushimin e Lehonisë; Amandamentimi i nenit 48,te Ligjit të Punës mbi zgjatjen e pushimit te Lehonisë. Inicuar nga Grupi Jo Formal I Grave.
- Takim pune për mbrojtjen e fëmijëve „Siguria dhe e drejta e fëmijës”
- Departamenti i te Dr. të Njeriut dhe Komuniteteve i mundësuar nga OSBE, temë kryesore dukuria negative e fëmijëve lypsarë.
- NJDNJ monitoron punimet e asamblesë komunale,merr pjesë në takimet e Komitetit të komuniteteve. në mbledhjet e organizuara nga Zyrtari për Kthim, ka bashkëpunim me OJQ-të e Gruas,dhe me SHIP, gjithashtu edhe bashkëpunon me ekipin komunal të OSBE-së pran etj

Komuna e Podujevës

Takim pune me Divizionin e Njësitit për të drejtat e njeriut nga MAPL-ja lidhur me funksionimin e Njësisë për të drejtat e njeriut të kësaj komune.

Është mbajtur tryezë e rrumbullaket me temën “Promovimi i të drejtave të minoriteteve në Kosovë”. Kjo tryeze është organizuar ne kuadër te projektit “Promovimi i te drejtave te minoriteteve dhe integrimi i tyre”qe implementohet nga KMDLNJ.

Zyrtarja për Barazi Gjinore ne bashkëpunim me ,Ekipin Komunal te OSBE-se ne Podujeve, Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport ,Drejtorja për Arsim ka planifikuar dhe bërë përgatitjet për shënimi e 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare te Gruas me një tryezë te rrumbullaket ,Progres për gratë progres për shoqërinë” Vizita ne zonat rurale,gjithsejtë ne gjashte fshatra me grupet e grave dhe si rrjedh e këtyre vizitave se bashku me OSBE-ne kemi mbajte debate me këto grupe te grave me temën „Duamë mësojmë me shume dhe tu dëgjojmë ju”

Komuna e Rahovecit

Me Udhëzimin Administrativ -MAPL - Nr. 208/02 për themelimin e Njësave për të Drejtat e Njeriut në Komuna, edhe me Statutin Komunal është paraparë themelimi i NJDNJ, si mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës. Kjo zyrë, si pjesë e institucionit komunal si fushëveprim të vet ka promovimin e plotë të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të komuniteteve.

Aktivitetet e kësaj zyre në kuadër të NJDNJ gjatë periudhës gjashtëmujorësh janë të shumta:

- Në këtë kuadër, kjo zyrë merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore, këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e

ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë.

- NjDNj, ka zhvilluar këto aktivitete:
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas 8 Marsi, me rast janë ftuar nënat , gratë dhe motrat e dëshmorëve , gjithashtu u stimuluan punëtorët e K.K, Rahovec me nga një dhuratë modeste me vlerë prej 10€.
- Takime të rregullta me Organizatat joqeveritare në Komunën e Rahovecit.
- Marrja pjesë në intervista të radios me temën, "Ngritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i saj", "Kuvendi Komunal për personat me aftësi të kufizuar".
- Organizim i mbledhjeve informative-konsultativ me OJQ-të lokale të grave K. Rahovec.
- Dhënia e informatave dhe njoftimeve të ndryshme në DNJDNJ - MAPL dhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, si dhe plotësimin e pyetësorëve;
- Pjesëmarrje 5 ditore ne Prishtinë ne një trajnim me 15 Gratë e veja nga Krusha e Madhe financuar nga Organizata Partners Kosova , nga i cili trajnim gratë janë ndarë shumë te kënaqura dhe në gusht 3 nga këto gra do te certifikohen për trajnere, ndërsa te tjerët janë trajnuar qe te përgatisin projekt propozime për te konkurruar ne projekte te arsyeshme dhe te dobishme dhe te kërkojnë donacione nëpër organizatat e ndryshme.
- Marrja pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën: Bazat ligjore kundër korrupsionit-Projekt ligji për financimin e subjekteve politike e organizuar nga KDI në mbështetje të USAID
- Marrja pjesë në punëtorinë 3 ditore ne Mavrovë të Maqedonisë për përpilimi i planit të punës për Kolegjiun për vitin 2010 / 2013 Avokim në përkrahjen e shoqatave me PAK në Drejtorinë e Shëndetësisë për mbështetje financiare të shpenzimeve operative (komunale);
- *Bashkëpunimi me OSCE, UHCR, KFOR-in , etj. lidhur me rastet e dhunës në familje, për pozitën e femrës në familje, në shkollë, shoqëri dhe në përgjithësi;
- Arritja e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në mes ZBGJ dhe subjekteve që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe përkrahjen e viktimave të dhunës në familje;
- Pjesëmarrja ne debatin mbi prezantimin e Draft -Plani strategjik për organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin Para Universitar në Kosovë
- Përcjellja e të dhënave në Ministrinë e Shëndetësisë me kërkesën e koordinatores të njësitit të drejtave të Njeriut, mbi gjendjen e anëtarëve të minoriteteve RAE ,të cilët janë rikthyer në Komunën e Rahovecit prej vendeve të Evropës Perëndimore.

- Pjesëmarrje në trajnim tre ditor me këshilltarët komunal . Seminari është organizuar me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes te kapaciteteve të përfaqësuesve në vendimmarrje.
- Takim i rregullt me Agjensionin për Barazi Gjinore-Prishtinë
- Vazhdimësi e trajnimit me Agjensionin për Barazi Gjinore me qëllim të rishikimit të PKBGJ.
- Koordinimi i punëve dhe bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut.. Bashkëpunimi i rregullt i NJDNJ me Institucionin e Ombudspersonit.
- Integrimi i barazisë gjinore në komunën e Rahovecit, që do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike e politike dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialin e tyre individual në dobi të shoqërisë((Zbatimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore), Implementimi i LBGJ, në K.K të Rahovecit , Pjesëmarrja e femrave ne Administratën e Komunës së Rahovecit është 20 femra , në pozita vendimmarrëse nuk ka asnjë drejtoresha .Jemi larg zbatimit të ligjit për barazi gjinore ku cekët se pjesëmarrja e femrave duhet të jetë 40%. Numri i punësuarve ne Kuvendin Komunal të Rahovecit duke mare për bazë edhe femrat te punësuar ne Arsim dhe Shëndetësi është gjithsej 1095 ku prej tyre 314 femra dhe 781 meshkuj , prej këtyre vetëm një Drejtoresh femër ne shkollën e mesme ne Rahovec dhe një tjetër ne Çerdhe te Fëmijëve ne 24 shkolla fillore dhe 3 te mesme .
- Pjesëmarrje në punëtoria një ditore organizuar nga DDNJ-MAPL për NJDNJK-të, në Vermic me temë: shpronësimi.

Sipas Plan-programit të hartuar për zhvillimin e aktiviteteve të të Drejtave të Fëmijëve gjatë vitit kalendarik 2010 , janë ndërmarr këto hapa :

- Në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës sonë janë formuar Këshillat e shkollave për të Drejtat e Fëmijëve në të cilët kanë marr pjesë nga një delegatë nga çdo klasë.
- Nga këto Këshilla janë deleguar nga një delegatë sipas numrit të nxënësve (diku edhe nga dy) të cilët e kanë formuar Asamblenë Komunale të Fëmijëve, e cila ka gjithsej 31 delegatë e prej tyre 2 janë të kombësisë serbe dhe një i komunitetit ashkali.
- Këta Këshilla të shkollave mbajnë mbledhje veta rregullisht ku i shqyrtojnë të gjitha padrejtësitë në raport : nxënës-arsimtar dhe nxënës-nxënës.
- Në muajin qershor u organizua ekskursioni 5-ditor multietnik i nxënësve te cilët morën vendet e para ne garat shkollore si shpërblim e morën këtë udhëtim në Budvë (Mal të Zi).

Komuna e Mamushës

- Ruajtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut si element kyç për barazi të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunë.
- Mbajtja e mbledhje së kuvendit komunal për të drejtat e njeriut, ku tema kryesore ishte hapja e vendeve të reja të punës, shëndetësi në komunë dhe shkollimi.
- Organizimi i debatit publik, për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut.
- Aktivitete lidhur me personat me aftësi të kufizuara, dhe të drejtat e tyre. Krijimi i kushteve më të mira për PAK, zbatimimi i PV dhe Strategjisë për PAK.
- Pjesëmarrja në takimin e mbajtur me OJQ-të, lidhur me të drejtat e minoriteteve në këtë komunë, punësimi dhe shkollimi i tyre.
- Është bërë analiza gjashtë mujore për të drejtat e njeriut dhe si rezultat ka dal se sipas aktiviteteve të bëra është bërë sensibilizimi i mirë i qytetarëve për të drejtat e tyre.

Komuna e Suharekës

Aktivitete në gjashtëmujorin e parë:

- Identifikimi i mangësive të rregulloreve komunale lidhur me të drejtat e njeriut, krahasuar me legjislacionin vendor dhe standardet e aplikueshme evropian dhe ndërkombëtare.
- Harmonizimi i rregulloreve komunale me legjislacionin vendor dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- Monitorimi i rekrutimit në punësim në kontekst të të drejtave të njeriut. Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë.
- Organizimi i fushatave dhe trajnimeve, përfshirë përkrahjen e programeve kundër duhanit, drogës, pijeve alkoolike etj. veçanërisht për fëmijët.
- Ngritja e vetëdijes për dëmet e duhanit ndaj shëndetit.
- Mbrojtja e ambientit në kontekst të të drejtave të njeriut, Hartimi i një politike me rekomandime për menaxhimin e mbeturinave.
- Krijimi i një rrjeti të përshtatshëm dhe i harmonizuar i pikë vendosjes dhe sistematizimit të mbeturinave.
- Pjesëmarrja në trajnime e organizuar nga NJDNJK, shoqëria civile dhe mediet për promovimin dhe zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me lirinë themelore të të drejtave të njeriut.
- Promovimi i Konventës për PAK. Integrimi dhe socializmi i personave me aftësi të kufizuara, krijimi i kushteve të përshtatshme të PAK.

- Integrimi i barazisë gjinore, pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike e politike dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë.

Komuna e Hanit të Elezit

Realizimi i projektit nga NJDNJ, për bashkëpunimin me Teatrin Kombëtar lidhur me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në çdo hapje të ndonjë filmi.

Realizimi i Projektit Durrësi 2010, ku përfshin një pushim 7 ditor për personat me aftësi të kufizuar, organizuar nga NJDNJK financuar nga KK dhe OSBE .

Pjesëmarrja në takimet e rregullta të Kuvendit Komunal dhe pjesëmarrja në takimet e rregullta me bordin e drejtorëve.

Komuna e Ferizajt

- Monitorimi i rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në intervista.
- Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë
- Ofrimi i rekomandimeve për rregulloren Komunale për Ngarkesa, Taksa dhe Gjoha, për lirim nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësi.
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve më të mira për qytetarë në sektorin e Ofiqarisë si dhe sektorë tjerë.
- Zhvillimi i pyetësorit me nxënësit për ndikimin e pijeve alkoolike dhe duhanit në mësim.
- Mbajtja e takimeve dhe tryezave me qytetarë (grupmosha të ndryshme) për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
- Shqyrtimi i ankesave për shkelje eventuale të të drejtave të njeriut Organizimi i tryezës “ Jo lule një ditë, por barazi çdo ditë” .
- Formimi i Grupit Joformal të Grave. Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës
- Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve Financuar nga KMDLNJ
- Organizimi i debateve publike me Drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve
- Organizimi i një shfaqje teatrale për fëmijë
- Organizimi i debatit “ Luftimi i dukurive negative të rinia”

- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të
- Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Parandalimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore.
- iniciativa dhe hartimi i projektit “ Mbrohu nga trafikimi me qenie njerëzore”
- Hartimi botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve për nxënës të shkollave të mesme;
- Shpërndarja e fletëpalosjeve “ Siguria e vajzave të reja “

Komuna e Shtërpçës

Gjat kësaj periudhe janar-qershor Njësia për të Drejtat e Njeriut kemi pasur takime të ndryshme në kuadër të veprimtarisë së kësaj njësie ser takimesh , mbledhje , tryeza të rrumbullakta , seminare dhe trajnime, trajtim i disa qeshtëjeve që kanë të bëjnë me ankesat e qytetarëve, disa aktivitete në lidhje me vetëdijimin mbi të drejtat e njeriut , barazisë gjinore si dhe mundësitë të barabartë.

Aktiviteti ynë, si njësi për të drejtat e njeriut është orientuar në:

- Përcjelljen e mbledhjeve të kuvendit, të cilat i kemi monitoruar në të gjitha.
- Takimi me OJQ Paqja dhe diskutimi për qëshjet e bashkëpunimit lidhur me të drejtat elementare të njeriut, barazisë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve.
- Shenimi i ditës së gruas - 8 marsit - tryezë e rrumbullakt me gratë e institucioneve , diskutime mbi barazinë gjinore si dhe problemet e gruas në jetën shoqërore dhe politike.
- Vizitë në disa shkolla fillore dhe të mesme, vlerësimi i kushteve dhe ambjentit në të cilat zhvillohet mësimi.
- Kam marrë pjesë si vëzhgues në intervistë gjat pranimit të shërbyesve civil të cilat janë mbajtur Brenda kësaj periudhe në Komunë,
- takime të rregullta me antarët e draft marrvëshjes, me zyrtarët për barazinë gjinore dhe institucioneve relevante në komunë ku vlen të potencohet një bashkëpunim i mirë mes tyre .
- Ofrimi i ndihmës në zyrën e pritjes në lidhje me pajisjen e qytetarëve me dokumentacion të nevojshëm për letërnjoftim dhe pasosh si dhe ofrimi i ndihmës së qytetarëve në lidhje me kompletimin e kërkesave për dokumentacionin e nevojshëm.
- Takime të shpeshta dhe diskutime për çështjet aktuale në komunë me OSCE-në

- Ndjekja e seminareve trajnimeve
- Takime te ndryshme me drejtoritë pran kuvendit komunal dhe institucionet tjera lokale etj
- Qershorë-Shënimi I 1Qershorit-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve-ku është bërë vizitë nxënësve të shkollës fillore në Firajë.
- Janë ndërmarrë edhe aktivitete lidhur me njoftimin për të drjetat e njeriut, të fëmijëve si dhe të drejtat për barazi gjinore.

REKOMANDIME

DDNJ e MAPL-së rekomandon:

- Respektimin i afatit ligjor për raportim nga NJDNJK-të;
- Përmirësimi i barazisë gjinore në pozitat vendimmarrëse;
- Fuqizimi i Njësive për të Drejtat e Njeriut në komuna;
- Të përkrahen NJDNK-të edhe më tej nga strukturat e larta komunale;
- Të krijohet një linjë e veçantë buxhetore për zhvillimin e aktiviteteve dhe projekteve të NJDNJK-ve;
- Komunitat që ende nuk kanë kompletuar stafin, ta bëjnë atë në afat sa më të shkurtër;
- Të ju sigurohet zyrtarëve të NJDNJK-së qasje në hartimin e politikave, strategjive, rregulloreve komunale, si dhe pjesëmarrje në takimet e stafit të lartë, në panelet intervistuese, me qëllim të monitorimit të respektimit të drejtave të njeriut;
- Të vazhdojë përcjellja e trajnimeve me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve të tyre;
- Të mbështeten NJDNJK-të në ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e përvojave përmes vizitave studimore në shtetet tjera;
- Të gjitha komunitat të shqyrtojnë mundësitë buxhetore për harmonizimin e koeficientve të koordinatorëve dhe zyrtarëve të NJDNJK-ve të

Republikës së Kosovës, konform propozimeve të bëra në përshkrimin e detyrave të punës nga MAPL-ja;

- Të gjitha komuant të nxjerrin rregullore për drejtat e fëmijëve, me qëllim të mbrojtjes së tyre nga dukuritë negative që po e rrezikon qenjen e tyre, (rregullore për te drejtat e fëmijëve ka nxjerr komuna e Drakgashit, Vitise dhe e Fushë Kosovës gjer më tani, sipas raporteve që posedojmë);
- Të gjitha NJDNJK-të, konstatojnë se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut në Ligjin e Punës neni 48 ku thuhet se pushimi i lehonisë zgjatë 3 muaj. Konsiderohet se është shkelje flagrante e të drejtave të fëmijës dhe nënës;
- Në rastet kur një nënë lindë bineq,treneq. Katërneq, persëneq e tj, pushimi i lindjes të zgjasë për secilin fëmijë nga 9 plus tre muaj.Të rregullohet mbështetja sociale për të posalinduri deri në moshën e duhur;

VËREJTJE

Raportin për gjashtëmuajorin e parë nuk e ka dërguar komuna e Junikut.